

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 31 MARS 2022

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Qytetare dhe qytetarë që ndiqni këtë seancë, në të cilën deri tani konstatoni se përpjekjet e opozitës për të nxjerrë të vërtetën e problemeve tuaja të mëdha, vuajtjeve, dhimbjeve, mospasjes dhe urisë, keni tablonë rozë të lumturimit që u bën qeveria me propagandë çdo ditë, nga mëngjesi në darkë, gënjeshtër, gënjeshtër dhe vetëm gënjeshtër. Po të ishin vetëm këto, do të ishin gjysma e së keqes, por e vërteta e pamohueshme është se kjo qeveri vepron dhe funksionon mbi ju dhe para jush si një organizatë e vërtetë kriminale.

Zhvillimet dramatike të javëve të fundit faktuan, në mënyrë të pakundërshtueshme, se qeveria, nga kreu i saj deri te nëpunësit më të thjeshtë të linjës, ka mbushur xhepat, valixhet, kontot me qindra e miliona euro me aferën e inceneratorëve. Ju përpiqeni t'i paraqisni këto si raste të shkëputura, por të gjithë ata që kanë abcnë e Kodit Penal, të gjithë ata që lexojnë nenin 28 të këtij Kodi gjejnë se ju jeni një megaorganizatë kriminale, sepse ajo vjedhje është bërë në bashkëpunim, ajo vjedhje është bërë në kundërshtim total me procedurat që përcakton ligji, ajo vjedhje është bërë me firma, që vijnë nga maja e piramidës dhe zbresin deri në bazë, ajo vjedhje është bërë duke shpallur të ndërtuara objekte, që nuk janë ndërtuar kurrë. Po ju pyes për diçka, më thoni çfarë quhet organizatë në qoftë se penalizohen nga drejtësia 20 apo 30 zyrtarë, në qoftë se janë penalizuar të gjithë, sepse kanë kryer vepra penale duke përvetësuar fonde, në qoftë se ata kanë arritur ta realizojnë këtë vjedhje të pashembullt në bashkëpunim, apo duhet të jenë njerëz të thjeshtë, që s'kanë kravata dhe nuk pispillojnë?

Duhet të jenë 3 djem të rinj, që të quhet organizatë kriminale dhe nëse janë 30 zyrtarë nuk është organizatë kriminale?! Po firmat e Bllakos, që meriton atje ku shkoi, po firmat e Ëngjëll Agaçit ku janë, po firma e Edi Ramës, në kundërshtim flagrant me ligjin, që firmos prokurime me procedurë të mbyllur, që nuk i parashikon ligji? Po si ka mundësi që një njeriut tuaj me 3, 5, 10 kompani i jepni tender për 500 e ca milionë dollarë? Dje u paraqitën dokumente nga zonja Kryemadhi që ai kishte marrë edhe 27 milionë dollarë të tjera për Vlorën, nga OSHEE e të tjera, e të tjera, ndërsa ai shëtit lirshëm. Ju vazhdoni të disbursoni fonde te kjo organizatë kriminale, sepse është juaja, jeni vetë. Por çfarë ka tjetër organizata kriminale?! Çfarë ka tjetër grupi i strukturuar kriminal me mbi 3 persona, përveç bashkëpunimit, përfitimit në kundërshtim me ligjin? Kjo është e vërteta dhe ju s'mund ta fshihni me asgjë. Jo dhe jo. Këtu është kriza, ky është themeli i krizës.

Zotërinj, dilni këtu dhe derdhni lot krokodili. Çfarë u bëhet këtyre pensionistëve? A t'ju them diçka unë këtu? Sipas INSTAT-it, ushqimet janë rritur jo me 3,3, aq sa rritët ju pensionet, ushqimet janë rritur me 7,3. Kush nuk e di në Shqipëri që pensionistit ato pak lekë që merr i shkojnë të gjitha ushqime dhe ilaçe? Mos u tallni me ta, sepse pensioni nuk arrin për asgjë tjetër. Ata maksimumi që mund të blejnë janë ushqime dhe ilaçe dhe thoni se i lumturuat, i indeksuat. Përkundrazi, sot, me gjithë rritjen që ju bëtë, ata marrin 4% më pak sesa merrnin më parë. Kush e shkaktoi krizën e energjisë? Kush e shkaktoi në vitin më

të lagët të historisë, vitin 2021, vit në të cilin u prodhuan nga turbinat ujore të këtij vendi 8,9 miliardë kilovat orë, në një kohë që konsumi tarifor është vetëm 5,3 miliardë kilovat orë? Çfarë ndodhi? Kush i zbrazti në mënyrë kriminale digat në muajt gushtshtator? E di se çfarë ndodh me ju?

Të supozojmë me të vërtetë që një drejtor i KESH-it u çmend ose të supozojmë që u korruptua kokë e këmbë dhe e shiti energjinë me 40 euro, ndërkohë që në bursë shitej me 120 euro; u çmend apo harroi çdo gjë dhe zbrazti digat gjatë muajve gusht dhe shtator, në një kohë kur nuk duheshin zbrazur kurrë, në një kohë kur duheshin ruajtur me çdo kusht si rezervë për vjeshtën, problemi është se pas kësaj nuk merret asnjë masë, nuk ndëshkohet askush. Përse? Sepse është organizatë kriminale. Sepse ai i ndan paratë me ministrin, me mbiministrin, se ndryshe që në aktin e parë atij duhet t'i tregohet ligji dhe drejtësia. Por nuk e ka bërë vetë ai, jo, është bërë siç është bërë vjedhja me inceneratorët, me djegësit. E kanë gjetur një mekanizëm. Cili është mekanizmi? Ta blej unë energjinë me 40 euro, ta shes në treg me 130 euro dhe 80 euro i ndajmë bashkë. A bëhet kështu, apo jo? Për krizën energjetike nuk kemi asnjë shkak tjetër përveç vjedhjes. Pse nafta në Kosovë sot shitet 1,7 euro, kurse në Shqipëri sot shitet 2,2 euro? Zotëria insiston të mos heqë taksat. Zotëri, të gjithë po i heqin taksat. Apo doni të ndaloni veturat? Edhe këtu ka vjedhje.